

Shtojca 12.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT,PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

03.02.2026

Drejtuar: O.B.KONSTRUKSION & ED KONSTRUKSION

Operatorit Ekonomik(OE) ☐ **ose**

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☒

*[O.B.KONSTRUKSION, K93728201A , 97.71% Durrës, Krujë, Qendër Krujë, Lagjia Nr. 1., ED
KONSTRUKSION, K61625001I, 2.29% Tiranë, Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin",
apartamenti 112, kati 11]*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☐

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Pune publike

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Furnizimi me ujë për fshatrat
Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastrë, REF-68208-11-10-2025, 12 muaj nga dita e nga data e
procesverbalit të lirimit (dorëzimit) të sheshit të ndërtimit (sipas grafikut të punimeve)]*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 11.11.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [17.11.2025] [71]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐ x

Sipas rëndësisë:

Çmimi	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanisë	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit	pikët 5

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 18 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

- a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]
 - I Kohën e mobilizimit në kantier (jo më shumë se 3 muaj) [2 pike].
 - II Grafiku i punimeve të Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k2a}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k2a}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2a}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mesiperme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shënim: Për përmbushjen e kriterit të mesiperm operatori ekonomik duhet të dorëzojë organigramen e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologji të nderveprimit midis

strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vleresimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k5}$	Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k5}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k5}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

*Shënim – Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret) duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☐

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. BOE DESARET COMPANY ME NUIS K01816001J & AURORA CONSTRUCTION ME NUIS K02017003I ME OFERTE EKONOMIKE 80,089,403.39 (Tetëdhjetë milionë e tetëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e tre lekë e tridhjetë e nëntë qindarka) LEKE PA TVSH
2. BOE NDREGJONI ME NUIS K31329048I & RAFIN COMPANY ME NUIS L52125110A ME OFERTE EKONOMIKE 87,854,937 (Tetëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë lekë) LEKE PA TVSH
3. BOE ERAL CONSTRUCTION ME NUIS K82230002K & STERKAJ ME NUIS J87905501G ME OFERTE EKONOMIKE 88,467,811.1 (Tetëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e shtatë lekë) LEKE PA TVSH
4. BOE AGI KONS ME NUIS K21622001M&NDERTIMI SHPK ME NUIS K11325002C ME OFERTE EKONOMIKE 90,422,898.36 (Nëntëdhjetë milionë e katërqind e njëzet e dy mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë presje tridhjetë e gjashtë).
5. ZDRAVA ME NUIS J84003411K ME OFERTE EKONOMIKE 98,462,741.34 (Nëntëdhjetë e tetë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dyzet e një presje tridhjetë e katër)
6. BOE SHKELQIMI 07 ME NUIS K68121808W & GRAND KONSTRUKSION M ME NUIS L38109801T ME OFERTE EKONOMIKE 100,000,000 (Njëqind milionë)
7. HASTOCI ME NUIS J62028009B ME OFERTE EKONOMIKE 104,783,327.22 (Njëqind e katër milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet e shtatë presje njëzet e dy).
8. BOE MANE'S ME NUIS J64103865K &NIKA ME NUIS J76705047U ME OFERTE EKONOMIKE 107,658,963.12 (Njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tre presje dymbëdhjetë).
9. BOE K.M.K ME NUIS L78223801E & CAUSHI M ME NUIS L88419801O ME OFERTE EKONOMIKE 108,024,938 (Njëqind e tetë milionë e njëzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë).
10. LIQENI VII ME NUIS K01730502W ME OFERTE EKONOMIKE 108,261,678.89 (Njëqind e tetë milionë e dyqind e gjashtëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tetë presje tetëdhjetë e nëntë).
11. BOE LIS KONSTRUKSION ME NUIS K66613407H &VIANTE KONSTRUKSION ME NUIS K47103804L ME OFERTE EKONOMIKE 110,048,112.16 (Njëqind e dhjetë milionë e dyzete e tete mije e njeqind e dymbëdhjetë pike gjashtëmbëdhjetë).
12. BOE ERGI ME NUIS K02727229P & BE-IS SHPK ME NUIS K71412003A ME OFERTE EKONOMIKE 111,335,158 (Njëqind e njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) LEKE PA TVSH
13. BOE OB KONSTRUKSION ME NUIS K93728201A & ED KONSTRUKSION ME NUIS K61625001I ME OFERTE EKONOMIKE 115,448,500 (Njëqind e pesëmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind).
14. SHENDELLI ME NUIS K07924803N ME OFERTE EKONOMIKE 128,374,342 (Njëqind e njëzet e tetë milion e treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e treqind e dy) LEKE PA TVSH

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomik “ SHKELQIMI 07” me Nr. NIPT K68121808W & “ GRAND KONSTRUKSION” me Nr. NIPT L38109801T, me oferte ekonomike 100,000,000 lekë pa tvsh.

Bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar në SPE për kete procedure prokurimi nga bashkimi i operatoreve ekonomik, si dhe pas shqyrtimi te tyre nga komisioni i vlerësimit te ofertave rezulton se ne plotesim të pikës 2.3.4 të kapacitetit Teknik si më poshtë:

Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Nga verifikimi i kontratës së bashkëpunimit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik dhe ndarja e zërave të punimeve që ka marrë pësipër për të realizuar secili anëtar i BOE rezulton se shoqëria “GRAND KONSTRUKSION” ka marrë përsipër për të realizuar zërat si më poshtë:

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA	85.0%	15.0%
							Shkelqimi 07	Grand Konstruksion M
		1. PUNIME GERMIMI						
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	5,000.00	230.00	1,150,000.00	1,150,000.00	-
2	3.45/I	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² >	m3	1,700.00	2,600.00	4,420,000.00		4,420,000.00
3	3.16I	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 1 m3 >	m2	3,500.00	25.00	87,500.00	7,500.00	80,000.00
4	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	4,000.00	230.00	920,000.00	920,000.00	-
5	3.45/I	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m² >	m3	1,600.00	2,600.00	4,160,000.00		4,160,000.00
6	3.16I	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 1 m3 >	m2	5,000.00	25.00	125,000.00	125,000.00	-
7	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet >	m3	6,936.60	230.00	1,595,417.26	1,595,417.26	-
8	3.16I	Rrafshim skarpate ne germim, ekskavator 1 m3 >	m2	5,000.00	25.00	125,000.00	25,000.00	100,000.00
9	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet >	m3	7,000.00	160.00	1,120,000.00	500,000.00	620,000.00
10	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet >	m3	1,500.00	160.00	240,000.00	40,000.00	200,000.00
11	3.104/b	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, toke zak, kategoria IV, me shk ne mjet >	m3	1,500.00	160.00	240,000.00	40,000.00	200,000.00

		Shuma 3:				778,300.00	778,300.00	-
		4. PUNIME DHEU						
74	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	2,634.00	200.00	526,800.00	500,000.00	26,800.00
75	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	2,435.00	200.00	487,000.00	450,000.00	37,000.00
76	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	3,942.00	200.00	788,400.00	750,000.00	38,400.00
77	2.5a	Germim e mbushje dheu me krah kat IV per themele, h=1.5m >	m3	35.00	3,200.00	112,000.00	-	112,000.00
78	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	72.00	200.00	14,400.00	-	14,400.00
79	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	72.00	200.00	14,400.00	14,400.00	-
80	2.5a	Germim e mbushje dheu me krah kat IV per themele, h=1.5m >	m3	35.00	3,200.00	112,000.00	-	112,000.00
81	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km >	m3	72.00	200.00	14,400.00	-	14,400.00
82	2.19a	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria IV >	m3	79.00	800.00	63,200.00	-	63,200.00
83	2.30a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinzhir 0.5m3, shkarkimi ne auto >	m3	50.00	140.00	7,000.00	7,000.00	-
84	2.37/2a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km >	m3	260.00	125.00	32,500.00	32,500.00	-
85	2.19a	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria IV >	m3	30.00	800.00	24,000.00	-	24,000.00
86	2.30a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinzhir 0.5m3, shkarkimi ne auto >	m3	20.00	140.00	2,800.00	2,800.00	-
87	2.37/2a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 2.0 km >	m3	30.00	125.00	3,750.00	3,750.00	-
88	2.19a	Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, kategoria IV >	m3	25.00	800.00	20,000.00	-	20,000.00
89	2.30a	Germim dheu themele e plinta me b-2m, ekskavator me zinzhir 0.5m3, shkarkimi ne auto >	m3	15.00	140.00	2,100.00	2,100.00	-

Zërat e marrë pësipër nga operatori ekonomik kanë të nevojshëm që operatori të jetë i pajisur me licensën përkatëse të kërkuar dhe nga AK në dokumentat standarte të tenderit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se ky operator ekonomik nuk disponon licensën e kërkuar.

Referuar sa më sipër KVO gjykon se në kriterin e veçantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë Licence lidhur me ndikimin ne mjedis kodit III.2.B, Grumbullim transportim i mbetjeve urbane inerte".

Për sa më sipër, Komisioni i vleresimit te ofertave gjykon se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh rezulton se operatori ekonomik në paraqitjen e ofertës ekonomike ka përllogaritur makineri pajisje me tvsh

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga BOE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. "Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar" ndërsa në pikën 6 "Çmimet" është përcaktuar se: "Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës".

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik për plotësimin e ofertës ekonomike".

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatohet se ka paqartësi ç'ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përlllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) te ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE ne ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Gabim ne preventive pasi ka shtuar makineri pajisje ne shumat e analizave dhe fondin reserve 5% ja ka shtuar dhe makineri pajisjeve.

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përlllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës, nga ana e BOE vlere e ofertës pa TVSh është deklaruar vlere prej 100,000,000 lekë pa TVSH (vlerë e cila nuk e përfshin Pajisjet dhe vlerën e tyre).

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ofertues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlere ofertës me TVSh duhej përlllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $100,000,000 + tvsh = 120,000,000$ dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën $1,337,902.98 = 121,337,000$ dhe jo $120,000,000$ Në rastin konkret KVO gjykon, se operatori ekonomik nuk ka përfshirë ne oferten e tij vleren e paisjeve sipas preventivit ne kete procedure prokurimi.

Operatori ekonomik ka përlllogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke mos i përfshirë dhe makineri pajisjet.

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik kane mungese fizike te dokumentacionit te kerkuar, nuk plotesojne kriteret e kualifikimit pasi nuk kane paraqitur 1(nje) punonjes duralumin nga 2 (dy) te kerkuar.

Operatori ndodhet edhe ne **kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me**

ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në pajisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës së prokurimit .Në këto kushte, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të BOE.

2. Bashkimi i operatorëve ekonomik AGI KONS" sh.p.k, me Nr.NIPT-i K21622001M & "NDERTIMI" sh.p.k, me Nr.NIPT-i K11325002C , dhe ofertë ekonomike 90.422.898.36 lekë pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik në plotësim të kërkesave të AK për këtë procedurë prokurimi rezulton se BOE ka bërë gabime në ofertën ekonomike duke përlllogaritur dhe makineri paisje me tvsh, duke mos korresponduar me vlerën nga shtojca Nr.2 analiza e cmimeve.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përlllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) te ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje) + tvsh totale duke përfshirë punimet dhe paisjet.

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike

me TVSH duhet të ishte përlllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës, nga ana e BOE vlera e ofertës pa TVSh është deklaruar vlera prej 90,422,898.36lekë pa TVSH (vlerë e cila nuk përfshin Pajisjet dhe vlerën e tyre).

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera e ofertës me TVSh duhej përlllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $103,427,878.03 + 4,233,000$ pajisjet = 107,660,878.03 vlera pa tvsh që duhet të kishte ne oferte BOE dhe jo 108,507,478.03

Operatori ekonomik ka përlllogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë tvsh-ne edhe tek pajisjet.

Ne marreveshjen e bashkepunimit ndarja sipas operatoreve ekonomik është se shoqëria AGI CONS shpk merr persiper të realizojë objektin e kontratës në masën 70% të vlerës totale të punimeve dhe shoqëria Ndërtimi shpk merr persiper të realizojë objektin e kontratës në masën 30 % të vlerës totale të punimeve.

Ne referim të ndarjes së zërave të punimeve ku operatori ekonomik do realizojë 70% të punimeve operator ekonomik AGI KONS shpk nuk plotëson kriteret e kualifikimit pasi nuk ka paraqitur inxhinier mjedisi drejtues Teknik edhe pse ka marrë persiper realizimin e 70 % të zërave të preventivit që për të cilat është kërkuar inxhinier mjedisi drejtues Teknik.

Gjithashtu operatori ekonomik edhe pse ka marrë persiper realizimin e % së përmendura me siper të zërave të punimit duke përfshirë dhe ato të kontraksioneve metalike nuk ka paraqitur asnjë punonjes të tillë, montator për kontraksione metalike nga 2 punonjes të kërkuar në kriteret e kualifikimit në DST. Gjithashtu ky operator nuk ka paraqitur asnjë punonjes automakinist nga 2 të tillë të kërkuar në kriteret e kualifikimit edhe pse ka marrë 70 % të zërave të preventivit për të cilën kërkohet ky drejtues mjedesh të renda, automakinist.

Operatori ekonomik Ndërtimi shpk nuk ka paraqitur në shtojcën 8 të formularit të vetedeklarimit asnjë punonjes të thjeshtë nga 4 të kërkuar në kriteret e kualifikimit edhe pse do të realizojë 30% të punimeve sipas Akt-Marreveshjes.

Në arsyetim të skualifikimit të përmendur me siper ju sjellim në vëmendje dhe vendimmarrje të konsoliduar të komisionit të prokurimit publik ku qartësisht ka përcaktuar në vendimmarrjet e tij se operatorët ekonomik në rastet e BOE duhet të plotësojnë kriteret e kualifikimit në përputhje me % e pjesëmarrjes dhe elementeve konkret që do të realizojnë në Bashkim.

Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.* Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh,

kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Në referim të sa me sipër ndodhemi në kushtet e njejta të një vendimarrjeje të komisionit të prokurimit publik, V E N D I M Nr. 1114/2023 Datë 02.11.2023 .

Bashkimi i operatorëve ekonomik AGI CONS shpk dhe NDERTIMI shpk, nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit 2.3.3 c, mbi paraqitjen e autorizim prodhuesi, lidhjen distributor prodhues, kataloge dhe certifikatave të certifikatë aprovimi nga një Insitucion Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar për artikujt Tuba Ujësjiellësi PE ,Tuba Korrogato/Brinjezuar PVC, Rakorderi , Saraqineska Gize dhe Matsa uji. sipas kriterëve të kualifikimit të DST.

Referuar dokumentacionit në SPE, gjendet dokumentacioni mbi kataloget për matsat e ujit janë të papërkthyer në shqip, dokumentacioni i cili mbi në kundërshtim me pikën 4.7 në dokumentat standarte të tenderit ku përcaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht ☐

Gjithashtu edhe certifikatave të certifikatë aprovimi nga një Insitucion Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që tubat janë për përdorim kanalizime nëntokesore dhe Saraqineska Gize, të paraqitet Certifikat Kalibrimi Sipas Direktivave të Enteve nën Presion janë të paraqitura jo në gjuhën shqip, kriter ky në kundërshtim me pikën 4.7 të DST ku përcaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Anglisht ☐

Shqip X

Në vlerësim dokumentacionit të paraqitur nga BOE në plotësim të kërkesave rezulton se nga paraqitja e formularit të vetdeklarimit të paraqitur nga AGI KONS shpk, rezulton se nuk ka deklaruar punëtor betonues , makineri asfaltoshtuese , prerese asfalti freze, nga ndarja e punimeve të deklaruar nga BOE rezulton se operatori ekonomik do të kryejë punime betonim, punime ku është e nevojshme presere e asfaltit dhe nuk disponon makinerite dhe burimet njerezore të nevojshme, gjithashtu për operatorin ekonomik NDERTIMI shpk ka deklaruar se do të kryejë punime për bashkimin e tubave por nuk ka pajisjet përkatëse konkretisht: Aparaturë për bashkim tubacionesh me metodën “Elektro Fusion” dhe Aparat saldimi për ngjitje të tubave koke me koke..

Komisioni gjykon, se qëllimi i shprehur qartësisht në nenin 88 pika 3 “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është që secili nga operatorët e bashkimit të mund të zotërojë kapacitete ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. Ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të

bashkimit nëpërmjet akt-marrëveshjes, bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Per sa me siper BOE skualifikohet per mospermbushje te kriterëve te hartuara ne DST nga AK.

3. **Bashkimi i operatorëve ekonomik Desaret Company” shpk NIPT K01816001J & Aurora Konstruksion” Sh.p.k me NIPT K02017003I me oferte ekonomike 80,089,403.39 leke pa tvsh.**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik rezulton se AK në dokumentat standarte të tenderit ka kërkuar

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojes së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët

ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” te ndryshuar).

Shoqëria Aurora Konstruksion” Sh.p.k në plotësim të pikës 2.3.1 ka paraqitur kontratën me objekt “ Përmirësimi I furnizimit me ujë për lagjen kraste e vogël ,Harmës dhe qytetin e Elbasanit, ne të cilën është Bashkim operatorësh dhe ka realizuar 22.2 % të punimeve ose 57,341,386.5 lek pa tvsh.

Konkretisht, ky operator ekonomik nuk ploteson kriterin per pune te ngjashme sipas kriterit a- me një kontratë të vetme në vlerën 50% te fondit limit (64,594,131 lekë pa TVSh), pasi nuk ka paraqitur asnje punë të ngjashme në këtë vlerë dhe as sipas kriterit b) ne vleren e dyfishit te fondit limit (258,376,524 lek pa tvsh x 40% (sa është pjesëmarrja në Bashkim = 105,675,998.3 lek pa tvsh) në shume kontrata, pasi kontratat e ngjashme nuk arrijnë vlerën e kërkuar.

Në bazë të përcaktimeve të legjislacionit për prokurimin publik, të parashikuara edhe në dokumentet e tenderit, bazuar edhe në konceptin e pergjithshëm të prokurimeve, objektet/ kontratat e ngjashme që të mund të konsiderohen të tilla duhet të plotësojnë në mënyrë kumulative elementin e kohës, vlerës dhe natyrës së ngjashme. Pra, objekti i përfunduar i kontratës duhet të jenë brenda afatit (elementi kohë), duhet të plotësojnë madhësinë e kërkuar nga autoriteti kontraktor, 50% apo 200% (elementi vlerë) dhe duhet të jenë të ngjashme me objektin që prokurohet (elementi natyrë e ngjashme). Mungesa qoftë edhe një prej ketyre elementëve e bën të pavlefshëm eksperiencën e ngjashme të paraqitur nga kandidati ofertues. Sa më sipër, Operatori Ekonomik “Aurora Konstruksion” shpk, nuk plotëson punën e ngjashme.

Në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi I operatorëve ekonomik rezulton se bashkimi I operatorëve ekonomik ka paraqitur sigurimin e ofertës me një afat vlefshmërie prej 150 ditësh dhe jo 180 ditë sic është kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit.

Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë: Loti 1 _____ (shuma,monedha) Loti 2 _____ (shuma monedha)

Autoriteti/ Enti ontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor.

Autoriteti/Enti Kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën: i. garancisë bankare X ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: **180 (shprehur në ditë)**

Seksioni 4: Procedura III.2.3 Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët EkonomikëA. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njëërën nga format e mëposhtme:

- a) Pagesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor
- b) Garanci bankare
- c) Garanci sigurimi Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
 - ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
 - d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
 - dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”
- Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë

kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Neni 83 Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohej nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Komisioni vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kërkesave/ kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Gjithashtu shoqëria DESARET Company ka paraqitur si drejtuese teknike në punimeve në objekt Ing. Donika Thaka me profesion Inxhinier Hidroteknike, shoqëria AURORA ka paraqitur si drejtues Teknik i cili do të ndjek punimet Z. Albert Myftiu, me profesion Inxhinier Hidroteknik, i gje e cila bie në kundërshtim me në kundërshtim kjo me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”.

Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se “Kreu I, pika 2, Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2.1 Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, **me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.** 2.2 Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësi të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.

Në referim të vendimit të kësaj lloji, ju paraqesim vendim të ngjashëm vendimi V E N D I M Nr. 285/2025 Datë 25.02.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar

në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përlllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh +, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur 74,229,803.39 + 4,883,000 paisjet = 79,112,803 vlera pa tvsh qe duhet te kishte ne oferte BOE dhe jo 80,089,403.39 leke.

Ndersa oferta me tvsh duhet te ishte 74,229,803.39(shuma analiza+fondi rezerve 5%)+tvsh 14,845,960.68+ shuma pajisje pa tvsh 4,883,000 leke dhe ne total oferta me tvsh e BOE duhet te ishte 93,958,763 leke me tvsh dhe jo 94,935,346.07 leke me tvsh.

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor bëri s`kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomik shoqëria “**Desaret Company” shpk & Aurora Konstruksion” Sh.p.k.**

4. Bashkimi i operatorëve ekonomik ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk & Sterkaj shpk me ofertë ekonomike 88,467,811.1 lek pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi I operatorëve ekonomik në plotësim të kriterëve të vendosura nga AK për këtë procedurë prokurimi rezulton se sigurimi I ofertës I paraqitur është 150 ditë nga 180 ditë të kërkuar nga AK për këtë procedurë prokurimi në dokumentat standarte të tenderit.

Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin:

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët Ekonomikë

A. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël). Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë: Loti 1 _____ (shuma,monedha) Loti 2 _____ (shuma monedha)

Autoriteti/ Enti ontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/ entit kontraktor.

Autoriteti/Enti Kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën: i. garancisë bankare X ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Periudha e vlefshmërisë së ofertës: **180 (shprehur në ditë)**

Seksioni 4: Procedura III.2.3 Në dokumentet standarde të tenderit, ne seksionin.

Seksioni I: Udhëzime për Operatorët EkonomikëA. TË PËRGJITHSHME autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.

2. Sigurimi i Ofertës mund të paraqitet në njëërën nga format e mëposhtme:

- a) Paguesa nga ofertuesi, në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit kontraktor
- b) Garanci bankare
- c) Garanci sigurimi Dokumentet e mësipërme duhet të jenë të vlefshme gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Ofertës.

3. Periudha e vlefshmërisë së Ofertës fillon nga momenti i hapjes së ofertave.

Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

Në nenin 77, pikat 1, 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 83, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Neni 83 Sigurimi i ofertës

1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, ndërkohë që mund të kërkojë paraqitjen e këtij sigurimi edhe në procedurat nën kufirin e lartë monetar, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente.

3. Autoriteti ose enti kontraktor konfiskon sigurimin e ofertës në rast të: a) tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; b) refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit. c) mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

4. Autoriteti ose enti kontraktor nuk e pretendon vlerën e sigurimit të ofertës dhe kthen menjëherë mbrapsht dokumentin e sigurimit të ofertës, nëse: a) ka përfunduar afati kohor i sigurimit të ofertës; b) është lidhur kontrata dhe është paraqitur sigurimi i kontratës, kur një gjë e tillë kërkohej nga dokumentet e tenderit; c) janë anuluar procedurat e tenderit pa shpallur fitues.

5. Autoriteti ose enti kontraktor raporton pranë Agjencisë së Prokurimit Publik rastet e tërheqjes së operatorit ekonomik sipas parashikimeve të këtij neni.

6. Kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk nënshkruan kontratën, autoriteti kontraktor bën konfiskimin e sigurimit të ofertës. Në rastin kur është përdorur si kriter i përcaktimit të ofertës fituese “oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim” dhe kur ofertuesi fitues nuk bën sigurimin e kontratës ose nuk arrin të nënshkruajë kontratën, autoriteti kontraktor përzgjedh ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur, vetëm nëse diferenca ndërmjet ofertës së kualifikuar në vendin

e parë dhe të dytë është jo më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës të ofertuesit që është tërhequr.

Komisioni vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kërkesave/ kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur, konkretisht deklarimeve të kryera nga bashkimi i operatorëve ekonomike dhe ndarja e punimeve që do të marrë përsipër secili prej anëtareve për të realizuar punën rezulton se operatori ekonomik "STERKAJ" shpk nuk ka deklaruar asnjë specialist betonues, dhe nga ndarja e punimeve rezulton se ky operator do të kryejë pjesën më të madhe të këtyre punimeve.

Në vijim të vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka marrë përsipër për të realizuar punimet e d/aluminit dhe ato të hekurkthyesit por nga deklaratimet e kryera rezulton se ky operator në formularin e përmbledhës të vetedeklarimit nuk ka asnjë prej punonjësve për kryerjen e tyre.

Gjithashtu në rezulton se operatori ekonomik ERAL Construction Company" Sh.p.k ka marrë përsipër për të realizuar punime hidraulike por nga deklaratimet e kryera rezulton se ky operator nuk ka anjë punonjës specialist hidraulik.

Mbështetur në nenin 88 të VKM Nr.285 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar konkretisht:

Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Referuar ofertes me ndarjen e zerave të punimeve që do të kryejë secili prej operatorëve ekonomik në këtë BOE, operatori ekonomik ERAL KONSTRUKSION shpk, nuk plotëson kriterin mbi specialistin hidraulik nga 2 dy hidraulike të kërkuar, pasi ka marrë përsipër realizimin e zerave të preventivit që kërkojnë punonjës hidraulik dhe në formularin e vetedeklarimit nuk ka paraqitur asnjë të tilla.

Gjithashtu operatori ekonomik Sterkaj shpk, nuk ka deklaruar asnjë punonjës punimesh duralumin nga 2 (dy) punonjës d/alumin të kërkuar në DST edhe pse ka marrë përsipër realizimin e zerave të punimeve të aluminit.

Operatori ekonomik Sterkaj nuk ka paraqitur asnjë punëtor në formularin përmbledhës të deklaratimit edhe pse ka paraqitur në aktmarrëveshje 76% të punimeve.

Mungesa e specialistëve të kërkuar për secilën nga anëtarët e BOE, bie në kundërshtim me nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet se:

*“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me **përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje**. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”*

Në referim të sa më sipër ndodhemi në kushtet e njehta të një prej vendimarrjeve të komisionit të prokurimit publik, V E N D I M Nr. 1114/2023 Datë 02.11.2023.

Në kuadër të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave ekonomike të paraqitura në procedurën e prokurimit, rezulton se operatori ekonomik **ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk & Sterkaj shpk** ka përfshirë **TVSH** në zërat e preventivit që lidhen me **makineritë dhe pajisjet e destinuara drejtpërdrejt për realizimin e investimit**.

Referuar **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, i ndryshuar**, makineritë dhe pajisjet që përfshihen në listën përkatëse përjashtohen nga aplikimi i TVSH-së, duke bërë që **vlera e TVSH-së për këta zëra të jetë 0 (zero)**.

Përfshirja e TVSH-së në këta zëra nga operatori ekonomik bie në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe përbën një **llogaritje të pasaktë të ofertës ekonomike**. Si pasojë, oferta e paraqitur nuk pasqyron koston reale të investimit sipas kërkesave ligjore dhe nuk është e krahasueshme në mënyrë të barabartë me ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë që kanë respektuar detyrimet ligjore përkatëse.

Në përputhje me parimet e **barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme**, si dhe me rregullat për vlerësimin korrekt të ofertave ekonomike, një ofertë e llogaritur gabim, për shkak të aplikimit të një elementi financiar që nuk duhet të ekzistojë (TVSH në vlerë zero), konsiderohet **ofertë e pavlefshme**.

5. **Bashkimi i operatorëve ekonomik “BE-IS” shpk & “ERGI” shpk me ofertë ekonomike 111,335,158 lek pa tvsh**

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomike në plotësim të kriterëve të vecanata të kualifikimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi si më poshtë:

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh rezulton se operatori ekonomik në paraqitjen e ofertës ekonomike ka përllogaritur makineri pajisje me tvsh

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga BOE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-vlerësimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Cmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatohet se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza

+ Fondi Rezervë (5.0%) te ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së paisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE ne ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Operatori ekonomik BE-IS shpk ka paraqitur certifikimin ISO 9001 ne gjuhet te huaj ne kundeshtim me kriterin e kualifikimit pika 4.7 te DST/ve ku percaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht ☐

Sa me siper, operatori ekonomik nuk ploteson kriterin e kualifikimit mbi certifikimin ISO pasi eshte ne gjuhe te huaj dhe i paperkthyer ne kundeshtim kjo me kriteret e pergjithshme te kualifikimit pika 4.7 , ku cdo dokumentacion ne kete procedure prokurimit duhet te jete shqip ose i perkthyer.

Akoma me tej, referuar kriterve te kualifikimit si dhe % se pjesemarrjes, 48% dhe ndarjes se zerave te elementeve konkret qe ka marre persiper ky operator ekonomik, është e nevojshme që ky operator ekonomik të zoteroj kete certifikim.

Ne nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “*Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me **përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.** Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.*”

BOE ndodhet edhe **kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike** ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në pajisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të

ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të BOE .

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ndodhet në kushtet e përlogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Operatori ekonomik ka përlogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh dhe pajisjet.

Per sa me siper BOE s’kualifikohet nga procedura e prokurimit.

6. Operatori ekonomik “ HASTOCI” shpk me oferte ekonomike me vlerë 104,783,327.22 lek

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në plotësim të kërkesave të AK për këtë procedurë prokurimi rezulton se:

Gjithashtu në deklarinimin e kryer nga operatori ekonomik rezulton se ka mangesi dhe në stafin e punonjësve të specializuar, konkretisht ate të teknikut të ndërtimit për të cilin operatori ka deklaruar vetëm 1 punonjës.

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga ky bashkim operatorësh rezulton se operatori ekonomik në paraqitjen e ofertës ekonomike ka përlogaritur makieri pajisje me tvsh Referuar **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 13.2.2013, “Për përcaktimin e listës së makinerive e të pajisjeve që janë drejtpërdrejt të lidhura me investimin dhe të procedurave të përjashtimeve e të kriterëve përkatëse”, i ndryshuar**, makineritë dhe pajisjet që përfshihen në listën përkatëse përjashtohen nga aplikimi i TVSH-së, duke bërë që **vlera e TVSH-së për këta zëra të jetë 0 (zero).**

Përfshirja e TVSH-së në këta zëra nga operatori ekonomik bie në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi dhe përbën një **llogaritje të pasaktë të ofertës ekonomike**

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga OE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në

këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatohet se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përlllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) të ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se OE ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përlllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlehtë Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përlllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $101,917,027.22 + tvsh = 122,300,432.6$ dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën $2,866,000 = 125,166,432.6$ dhe jo $125,739,992$ me tvsh, Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe OE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Gjthashtu nga detajimi i ofertes ekonomike ne shtojcen Nr,2 rezulton se operatori ekonomik ka shtuar tvsh per pajisjet konkretisht $2,886,300$ (vlera paisje) + $573,260$ (tvsh) = $3,439,560$ Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

Operatori ndodhet ne kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në pajisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .

Gjithashtu operatori ekonomik nuk ploteson kriteret e kualifikimit pasi nuk plotesojn kriteret e kualifikimit 2.3.3 c, mbi paraqitjen e autorizim prodhuesi , distributor kataloge dhe certifikatave te certifikatë aprovimi nga një Insitucion Institucion Ndërkombëtar ose Kombetar, per artikujt Tuba Ujësjiellësi PE ,Tuba Korrogato/Brinjezuar PVC, Rakorderi , Saraqineska Gize dhe Matsa uji sipas kriterëve te kualifikimit te DST.

Referuar dokumentacionit ne SPE, gjendet dokumentacioni mbi kataloget per saraqineskat, dhe matsave elektromagnetik janë te paperkthyer ne shqip, dokumentacioni, i cili mbi ne kundeshtim me piken 4.7 ne dokumentat standarte te tenderit ku percaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht ☐

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor vendos s`kualifikimin e operatorit ekonomik “HASTOCI” shpk

7. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Caushi M” shpk & K.M.K”shpk me oferte ekonomike

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga BOE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Cmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) të ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur 102,926,305 + tvsh= 123,511,566 dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën 5,098,632 = 128,610,198 dhe jo 129,629,925 me tvsh, Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe BOE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Operatori ekonomik ka paerllogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh dhe paisjet.

Në plotësim të pikës 2.3.1 të kapacitetit teknik, rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur punë të ngjashme si më poshtë:

Ndertim i tregut te gjelber Berat	4,337,550.17
Ndertim rruge Blloku Babrru	19,040,128.60
Ndertim rruge bedri karapici, hamdi pepo dhe bernardin palja	18,330,333.40
Rikonstruksion I rruges bejar diga e rezervuarit	12,692,920.80
Sistemim asfaltim I rruges fshatit Cercen NJ.Ad	
Hotolisht	4,087,300.30
Rikulaifikim lulishtes ne qender te qytetit te Elbsanit	535,543.90
Rikonstruksion I rruges Panahor-Ngarcan	10,604,001
Rikonstruksion rruga Kashta e kumtrit	1,536,706

Me një shumë totale prej 71,164,484.17 lek

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për përmbushjen e kriterit kualifikues, të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumentacionin e cituar si më sipër.

Nga krahasimi i kontratës së dorëzuar prej tij, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara, faturave tatimore të shitjes, me preventivin,

dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, Komisioni i Shqyrtimi të Ankesave gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor, me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë *(ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohor 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës)*, komponenti vlerë *(lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra*

a)-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

ose

b)-punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), si dhe komponentit natyrë e ngjashme *(i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre).*

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht, kontratat e paraqitur nga CAUSHI M sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është ujësjellës kanalizime etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës rrugore, etj,”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar, të paraqitur nga operatori ekonomik “CAUSHI M” sh.p.k., në përmbushje të kriterit për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit, nga krahasimi i situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të

sipërcituara, të realizuara nga operatori ekonomik “CAUSHI M” sh.p.k., me preventivin dhe relacionin teknik të objektit të prokurimit, Komisioni konstaton se ankimesi, dëshmon se ka kryer punime të ngjashme vetëm për një pjesë të projektit, e cila lidhet vetëm me gërmim dhe shtresa të ndryshme etj, por në asnjë rast nuk dëshmon se disponon eksperiencën e nevojshme për ndërtimin e rrjetit të ujësjellës kanalizimeve, të cilat kërkojnë ekspertizë dhe eksperiencë të ndryshme nga ato të dëshmuara nga ankimesi me anë të kontratës së sipërcituar, pasi edhe metodologjia e ndërtimit të tyre është e ndryshme.

Komisioni gjykon se krahasueshmëria e kontratave nëse janë të ngjashme nuk ka të bëjë vetëm me natyrën e kontratës nëse ajo është një kontratë pune publike, por duhet parë në lidhje me të gjithë zërat konkretë të punimeve të kryera. Në rastin konkret, pavarësisht se kontratat janë punë publike me objekte të gjëra veprimtarie, në zbatimin e këtyre kontratave nuk ka patur punime të ngjashme me një pjesë të rëndësishme të punimeve objekt prokurimi. Gjithashtu, KVO gjykon se për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me punimet objekt prokurimi, por edhe në përputhje me volumnin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Komisioni ka marrë në shqyrtim në themel kontratën e sipërcituar, pasi këto kontrata i përmbushin të tre komponentët, pra si komponentin vlefshmëri (që është brenda afatit pesëvjeçar), si komponentin ngjashmëri (që kanë objekt apo zëra të ngjashëm në situacion dhe fatura si zërat në preventivin e objektit të prokurimit) dhe si komponentin e vlerës së realizuar. KVO, pasi shqyrtoj kontratën e sipërcituar, të cilat i përmbushin të tre komponentët që karakterizojnë një kontratë të ngjashme, pra elementin kohë, elementin vlerë dhe elementin ngjashmëri, vëren, se nga përlllogaritja e kontratave, situacionet dhe faturat e paraqitura nga operatori ekonomik “CAUSHI M” shpk.

Nga përlllogaritja e punës së ngjashme që duhet të plotësojë operatori ekonomik CAUSHI M, duke qënë se pikën a) të kriterit e ka plotësuar në një punë të vetme operatori tjetër ekonomik që ka dhe përqindjen me të madhe në bashkëpunim, operatori ekonomik CAUSHI M referuar përcaktimeve ligjore duhet të plotësojë pikën b) të kriterit në raport me përqindjen e që ka në marrëveshjen e bashkëpunimit, konkretisht: $129,188,262 \times 200\% = 258,376,524$ $\times 40\% = 103,350,609.6$

BOE KMK shpk & CAUSHI M shpk kanë mangësi fizike pasi nuk kanë paraqitur dokumentacionin ligjor mbi specialistet teknik të kërkuar. Referuar formulave të vetdeklarimit shtojca 8 asnjë prej anëtarëve nuk kanë paraqitur 1 (një) specialist betonues.

Akoma me tej, referuar shtojcës 8) BOE kanë vetdeklaruar se zotërojnë punonjës duralumin të certifikuar pranë QTA e cila nuk është e akredituar për certifikimet punonjës duralumin.

Bashkimi i operatoreve ekonomik KMK & CAUSHI M shpk, nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit 2.3.3 c, mbi paraqitjen e autorizim prodhuesi, distributor kataloge dhe certifikatave të artikujt Tuba Ujësjellësi PE, Tuba Korroguar/Brinjezuar PVC, Rakorderi, Saraqineska Gize dhe Matsa uji.

Referuar dokumentacionit në SPE, gjendet dokumentacioni mbi kataloget dhe certifikatat e aprovimit për të gjitha mallrat/artikujt janë të paperkthyer në shqip, dokumentacioni i cili bie në kundërshtim me pikën 4.7 në dokumentat standarte të tenderit ku përcaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

BOE ndodhet edhe **kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike** ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të BOE .

Bazuar në Nenin 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor vendosi te beje s`kualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomik .

8. **Operatori ekonomik LIQENI VII shpk me oferte ekonomike 108,261,678.89 lek pa tvsh**

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi në plotësim të kërkesave të AK konkretisht:

në vlerësim të dokumentacionit, konkretisht ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik rezultron se ka përlllogaritje gabim lidhur më paisjet e preventivit, duke i llogaritur me tvsh.

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga OE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë

zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përlllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) të ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e pajisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për

mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përlogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefëta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përlogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $105,881,278.89 + tvsh = 127,057,534.6$ dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën $2,380,400 = 129,437,934.6$ dhe jo $129,914,014.67$ me tvsh, Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe BOE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Operatori ekonomik ka përlogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh dhe pajisjet.

Komisioni për raste të ngjashme i është referuar vendimit Nr.1217/2022 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit pasi nuk ka paraqitur një automakinist nga 2 dy të kërkuar në kriteret e kualifikimit.

Operatori ndodhet në kushtet e përlogaritjes gabim se ofertes ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore në fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Përlogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell një oferte ekonomike jo reale cka do të favorizonte në mënyrë të padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .

9. Bashkimi i operatoreve ekonomik MANE/S & NIKA , me ofertë ekonomike 107,658,963.12 lek pa tvsh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik në plotësim të kërkesave të AK për këtë procedurë prokurimi, konkretisht plotësimin e pikës 2.3.1 të kapacitetit Teknik

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- c. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- d. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojces 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vërtetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.

- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik NIKA shpk pjese e bashkimit të operatorëve ekonomik, në plotësim të pikës së sipërcituar ka paraqitur punën e ngjashme me objekt: Ndërtim i ujësjiellësit Bajzë, Malësi e Madhe.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se puna e ngjashme e paraqitur është realizuar si Bashkim operatorësh ekonomik, por nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se ky operator nuk ka paraqitur ndarjen e punimeve që ka realizuar secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik.

Në plotësim të punës së ngjashme, kur operatorët paraqesin punë të ngjashme të realizuar si BOE kanë detyrimin ligjor për të paraqitur ndarjen e zërave të punimeve që ka realizuar secili prej tyre, konkretisht si më poshtë:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e **bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.**

Përsa më sipër operatori ekonomik pjesë e BOE nuk plotëson punën e ngjashme duke qënë se ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

Operatori ekonomik NIKA shpk nuk ka deklaruar mjek gje e cila bien në referim të VKM nr. 742, datë 6.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”.

Në VKM nr. 742, datë 6.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001 të Këshillit të Ministrave “Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” është përcaktuar:

"2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.

2/2. Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e licencave

për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat", i ndryshuar.

*2/3. **Mjekët e ndërmarrjes merren në punë si nëpunës të ndërmarrjes dhe varen drejtpërdrejt nga punëdhënësi.** Punëdhënësi e njeh mjekun me detyrat e shërbimit shëndetësor të ndërmarrjes dhe kërkon zbatimin e tyre, sipas legjislacionit të punës. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

[...]

"12/1. Marrja në punë e mjekut është e detyrueshme për të gjitha subjektet, veprimtaria e të cilave

klasifikohet sipas vendimeve nr.459, datë 22.7.1998 "Për substancat e rrezikshme", nr.419, datë 4.8.2000 "Për objektet e rrezikshme" dhe nr.207, datë 9.5.2002 "Për përcaktimin e punëve të vështira ose të rrezikshme" të Këshillit të Ministrave, pavarësisht nga numri i të punësuarve.

12/2. Për subjektet që nuk përfshihen në pikën 12/1 të këtij vendimi, marrja në punë e mjekut të ndërmarrjes është e detyrueshme për ato ndërmarrje, ku numri i të punësuarve është jo më pak se 15 punonjës.

12/3. Mjeku i ndërmarrjes mban përgjegjësi sipas ligjit për pasojat, që mund të vijnë nga moszbatimi i detyrave të përcaktuara sipas pikës 2/4 të këtij vendimi."

Referuar formularit të vetdeklarimit shtojca 8, numri i të punësuarve që disponon operatori ekonomik NIKA shpik është shumë më i lartë se numri 15, i kërkuar nga VKM.

Në pikën 3 të nenit 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se: 3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, ***në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e kualifikimit dhe skualifikohet. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përputhen në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme

10. Bashkimi i operatorëve ekonomik NDREGJONI Sh.p.k & RAFIN COMPANY Sh.p.k, me oferte ekonomike 87,854,937 lek pa tvsh.

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomike, konkretisht formularit të ofertës ekonomike si më poshtë:

Gjithashtu në vlerësim të dokumentacionit, konkretisht ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik rezultron se ka përlllogaritje gabim lidhur me paisjet e preventivit, duke llogaritur me tvsh.

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga BOE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. "Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar" ndërsa në pikën 6 "Çmimet" është përcaktuar se:

“Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni I paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Cmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) të ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërllogaritjes të vlerës së paisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011

“Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përlogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përlogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $83,137,937 + \text{tvsh} = 99,765,524$ dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën $4,717,000 = 104,482,524$ dhe jo $105,425,924$ me tvsh, Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe BOE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Operatori ekonomik ka përlogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh edhe tek pajisjet.

Komisioni për raste të ngjashme është referuar vendimit Nr.1217/2022 të Komisionit të Prokurimit Publik.

BOE skualifikohet pasi Operatori ekonomik Rafin company ka deklaruar si drejtues teknike ne punimeve ne objekt Ing Z.Paqësor Malaj me profesion me profesion Inxhinier Hidroteknike, gje e cila bie ne kundeshitim me me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”.

Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se “Kreu I, pika 2, Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2.1 *Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* 2.2 *Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësi të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.*

Ne referim te vendimit tone te skualifikimit, ju paraqesim vendim te ngjashem vendimi

V E N D I M Nr. 285/2025 Datë 25.02.2025 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Ne kriteret e kualifikimit me ndryshime e shtojcat e bere ne SPE mbi mjetet e pajisjet teknike parashikohet se :

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë sigurimi); te vlefshme. Për mjetet e siguruara me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë rregjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. **Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse noteriale** të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike **duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit.**

Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Referuar Formulareve te vetdeklarimit shtojca 8 te dy kane deklaruar per fabrike asfalti dhe betoni kontrate furnizimi jo te lidhur para noterit konkretisht kane deklaruar fabrike asfalti, Nr.320.Prot date 09/12/2025 deri ne perfundim te projektit dhe Fabrike Betoni **Nr.320.Prot** date 09/12/2025 deri ne perfundim te projektit.

BOE ndodhet edhe **kushtet e perllogaritjes gabim se ofertes ekonomike** ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës se prokurimit. Në këto kushte , mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të BOE .

11. Operatori ekonomik SHENDELLI me oferte ekonomik 128,374,342 lek pa tvsh

Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur katalog dhe autorizime vetëm për tuba dhe për asnjë prej artikujve të tjere të kërkuar në dokumentat standarte të tenderit

Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE**
- ✓ **Tuba Korrogato/Brinjezuar PVC**
- ✓ **Rakorderi**
- ✓ **Saraqineska Gize**
- ✓ **Matsa uji**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut /ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.
- ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE dhe Rakorderi** të paraqitet certifikatë aprovimi nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që vërteton që tubat dhe rakorderit janë përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm.
- ✓ **Tuba Korrogato/Brinjezuar (KUZ)** të paraqitet certifikatë aprovimi nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që tubat janë për përdorim kanalizime nëntokesore.
- ✓ **Saraqineska Gize**, të paraqitet Certifikatë Kalibrimi Sipas Direktivave të Enteve nën Presion.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Ashtu sikurëse është kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit rezulton se ky operator ekonomik ka mangësi në dokumentat e dorëzuar për këtë procedurë prokurimi, përse më sipër operatori ekonomik skualifikohet.

Drejtuesi teknik Ing.Thanas Llahana me profesion Ing. Gjeolog gje e cila bie ne kundeshtim me ne kundeshtim kjo me Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar.

Vendim Nr.42, datë 16.1.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”, i ndryshuar, parashikon se: Kreu I “Drejtues teknik”- individ/ët e diplomuar në degët përkatëse të universitetit që është/janë përgjegjës/a për ndërtimin e objekteve sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës”.

Udhëzim Nr.2, datë 13.5.2005 “Për Zbatimin e Punimeve të Ndërtimit” i ndryshuar, parashikon se “Kreu I, pika 2, Detyra e drejtuesit teknik të sipërmarrësit është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës. 2.1 *Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.* 2.2 *Ndarja e detyrave dhe e përgjegjësi të sipërmarrësit e të kantierit, marrëdhëniet me investitorin, mbikëqyrësin, administratën publike dhe rregulli në kantier përcaktohen në rregulloren e brendshme, që hartohet nga sipërmarrësi i punimeve.*

Ne referim te vendimit tone te s'kualifikimit, ju paraqesim vendim te ngjashem vendimi V E N D I M Nr. 285/2025 Datë 25.02.2025 te Komisionit te Prokurimit Publik.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sqarojmë, se referuar rregullave të prokurimit publik, për kontratat për punë publike, për të provuar përvojën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë njërin prej dy kushteve të përcaktuara në nenin 39, pika 5 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ku operatori ekonomik duhet të

provojë, se ka kryer punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; ose të provojë se ka kryer punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Për përmbushjen e kriterit kualifikues, të përcaktuar në pikën 2.3.1 të dokumenteve standarde të tenderit, për punime të ngjashme gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur dokumentacionin e cituar si më sipër.

Nga krahasimi i kontratës së dorëzuar prej tij, situacioneve përfundimtare të punimeve në zbatim të kontratave të sipërcituara të realizuara, faturave tatimore të shitjes, me preventivin, dhe relacionin e specifikimeve teknike të objektit të prokurimit, të dhëna këto në dokumentet e tenderit objekt-prokurimi, Komisioni Vleresimit të ofertave gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmive të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, parë kjo në rrafshin krahasimor, me preventivin dhe relacionin e specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor, për sa i përket 3 komponentëve, si komponenti kohë (*ku Komisioni për këtë komponent do të marrë në konsideratë ato kontrata të cilat janë brenda afatit kohor 5 vjeçar nga data e njoftimit të kontratës*), komponenti vlerë (*lidhet me madhësinë e kontratës ose kontratave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriterin 2.3.1 pra*

a)-punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

ose

b)-punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), si dhe komponentit natyrë e ngjashme (*i cili lidhet me natyrën e ngjashme të kontratave të dorëzuara nga bashkimi i operatorëve ekonomikë me objektin e prokurimit nisur jo vetëm nga emërtesa e kontratës por edhe nga zërat e preventivave të tyre*).

Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për punë publike, ligjvënësi në nenin 39, pika 5 të Vendimit nr.285 datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë ose me sektorin privat me paraqitjen e vërtetimeve të shoqëruar dhe me fatura tatimore ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, *ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet*.

Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, Komisioni i vleresimit të ofertave konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërkimit të dokumentacionit

është brenda periudhës pesë vjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave.

Konkretisht, kontratat e paraqitura nga OE Shendelli sh.p.k, nuk mund të konsiderohen as si kontrata të ngjashme pasi nuk përmbushin karakteristikat e kontratës në natyrë, kompleksitet dhe metodologji. Natyra e objekteve të paraqitura nga OE nuk është e ngjashme pasi produkti është i ndryshëm. Produkti që kërkohet në objektin e prokurimit është ujësjellës kanalizime etj. Ndërkohë që punimet e ngjashme të paraqitura prej OE janë gjerësisht punime të infrastrukturës së kanaleve ujëtare, Kanaleve ujëtare me SEP, lugjeve Etj”.

- Rehabilitim i lugjeve egzistues përgjate kanalit kryesor ujëtare Peqin-Kavaje faza e parë
- Rehabilitimi i kanalit ujëtare Dukaj, (pastrimi i rezervuarit), Bashkia Tepelene
- Mur mbajtës në kolektorin Roskovec –Hoxhare , Fier

Për sa me sipër OE Shendelli pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të paraqitur në SPE ,komisioni vlerësimi të ofertave gjykon se është i kualifikuar.

12. Operatori ekonomik ZDRAVA me ofertë ekonomike. 98,462,741.34

Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi rezulton se :

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”.

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimues për plotësimin e ofertës ekonomike”.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje .

Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç’ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përlllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) te ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërlllogaritjes të vlerës së paisjeve në totalin pa tvsh. Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e paisjeve, pasi sipas përlllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përlllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përlllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefta Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës.

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera e ofertës me TVSh duhet të ishte përlllogaritur $\text{Shuma Analiza} + \text{Fondi Rezervë (5.0\%)} + \text{pa TVSh} + \text{tvsh}$ e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $96,992,241.34 + \text{tvsh} = 116,390,689.60 + \text{paisje } 1,470,500 = 117,861,189.6$ lek me tvsh

Nga detajimi i ofertes ekonomike në shtojcën nr.2 rezulton se oferta ekonomike me tvsh duhet të ishte 117,861,189.6 lek, duke mos futur në vlerën e tvsh edhe pajisjet të cilat nuk i bashkohen tvsh që marrin punimet civile.

Operatori ekonomik ka perlllogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh dhe pajisjet.

Komisioni për raste të ngjashme i është referuar vendimit Nr.1217/2022 të Komsionit të Prokurimit Publik.

Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe BOE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

OE ndodhet edhe **kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike** ne kundershtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .

13. LIS KONSTRUKSION shpk& Viante Construksion shpk

BOE ndodhet ne kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundershtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përlllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $108,788,012.16 + \text{tvsh} = 130,545,614.6 + \text{paisje } 1,260,100 = 131,805,714$ lek me tvsh

Nga detajimi i ofertes ekonomike ne shtojcen nr.2 rezulton se oferta ekonomike me tvsh eshte parqitur nga ana e operatorit ekonomik ne vleren 132,057,734.6 leke me tvsh, duke futur ne vleren e tvsh edhe pajisjet te cilat nuk i bashkohen tvsh qe marrin punimet civile.

Perllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .

Nuk ploteson kriterin mbi autorizimet , kataloget e saraqinesave dhe rakorderive jane ne gjuhe te huaj jo shqip gje e cila bie ne kundeshitim me dokumentacionin e tenderit pika me piken 4.7 ne dokumentat standarte te tenderit ku percaktohet se :

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip X

Anglisht ☐

Komisioni i vleresimit te ofertave per sa me siper gjykon dhe analizon se BOE LIS **KONSTRUKSION shpk& Viante Construksion shpk ka mungese dokumentacioni dhe shkelje te kriterëve te hartuara ne DST per kete arsye skualifikohet.**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [BOE O.B.KONSTRUKSION, Durrës, Krujë, Qendër Krujë, Lagjia Nr. 1 *ED KONSTRUKSION, Tiranë, Rruga "Abdi Toptani", Qendra "Torre Drin", apartamenti 112, kati 11*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 115,448,500 (*Njëqind e pesëmbëdhjetë milion e katërqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind*) lekë pa TVSH / totali i pikëve të marra [94,80] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.